



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Opsteg Sekretara/Office of the General Secretary

DATË/A:	15. 04.2013
REFERENC-Ë:	1962-3/13 - ZSP-321 /2013
PËR/ZA/TO:	N.SH. „SHKODRA”, Kamenicë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben ÇITAKU, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Sipas kërkesës suaj me nr. të protokollit: 1962-3/13, organi kompetent i MMPH-së ka shqyrtuar aplikacionin për Leje Ujore dhe ka vendosur si në Vendimin e bashkangjitur të kësaj letër përcjellëse.

Me respekt !

Faqe 1 nga 4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm/Kancelarija Stalnoq Sekretara/Office of the Permanent Secretary

Në bazë të nenit 56.1 të Ligjit Për Ujërat e Kosovës (Nr. 2004/24) dhe nenit 98 të LPA-së me Nr. 02/L-28, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor pas shqyrtimit të kërkesës ka nxjerrë këtë:

LEJE UJORE

APROVOHET kërkesa e kompanisë N.SH."SHKODRA", Kamenicë për shfrytëzimin e ujit nga pusi **P-1** me koordinata: X= 4 715494.464; Y=7 548175.887; Z=471 m; H=30m dhe pusi **P-2** me koordinata X= 4 715481.55; Y= 7 548208.005; Z= 469.70m; H=30 m në parcelen kadastrale me nr.1757-1-2-3 në Kamenicë.

Leja Ujore jepet me këto kushte :

- Sasia maksimale e shfrytëzimit të ujit nga **pusi P-1** me sasi max. **Q= 2.7 l/s** dhe **pusi P-2** me sasi max. **Q=2.7 l/s** të paraparë sipas dokumentacionit teknik;
- Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësve të vendosur në puse duhet të evidentoj: prurjen mesatare ditore në (l/s), sasinë ditore në (m³/ditë), sasinë mujore në (m³/muaj) dhe sasinë vjetore në (m³/vit).
- Për sasinë e shfrytëzuarë pala obligohet që deri në 15 Nëntor të vitit kalendarik të raportoj në MMPH sasitë reale të shfrytëzimit të ujit për pishinë dhe destinime tjera. Raportin duhet prezantoj në mënyrë tekstuale , grafike e analitike ;
- Obligimi për pagimin e kompensimeve për shfrytëzimin e ujërave do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPH-ja, sipas U.A. Nr. 06/2006, për Strukturën e Pagesave të Ujit;

Faqe 2 nga 4



- Afati i lëshimit të Lejes Ujore është 2 vjet me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;
- Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore bartësi është i obliguar që së paku 6 (gjashtë) muaj para skadimit të afatit të paraqes kërkesë për vazhdim të përdorimit;
- Pala obligohet që në afat prej 90 dite të hartoj dhe dorëzoj në MMPH Elaboratin teknik të shfrytëzimit dhe të shkarkimit të ujit në harmoni me praktikat e avancuara dhe legjislacioni në fuqi.

Arsyetim

Sipas kërkesë më nr. të protokollit: 1962-3/13, N.SH. “SHKODRA”, Kamenicë ka aplikuar për Leje Ujore lidhur me shfrytëzimin e ujit nga pusi për furnizimin e pishinës.

Pala kërkesës i ka bashkangjitur këtë dokumentacion investivo-teknik:

1. Formularin e aplikimit për Leje Ujore;
2. Elaborat mbi shfrytëzimin e ujit nga pusët e shpimit brenda hapësirës së pishinës N.SH.“SHKODRA“ .
3. Certifikatën e regjistrimit të biznesit të N.SH. “ Shkodra“;
4. Deklarata nga kompania NNT“Global project“;
5. Diploma e Mexhid Zylfiu.
6. Elaborati i Shkarkimit të ujërave të ndotura.
7. Plani i situacionit;

Në kuadër të procedurave për shqyrtim të kërkesave nga grupi punues të DU-së.

Në bazë të dokumentacionit – investivo teknik të dorëzuar, dhe në harmoni me politikat zhvillimore ekonomike të Kosovës është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Supreme të Kosovës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Nr: 1962-3/13 -ZSP-321/13 Datë: 15.04.2013
Prishtinë

T'i dërgohet :

1. Palës,
2. Kabinetit të Ministrit,
3. K. Kamenicë,
4. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
5. DU-së,
5. Arkivit të MMPH-së.

Sekretar i Përgjithshëm



Faqe 4 nga 4